

Sektori i veprave penale të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në përputhje me nenin 68 paragrafi (5) nga Rregullorja gjyqësore dhe nenin 31 nga Rregullorja e punës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr. 14/2022 të datës 20 janar 2022), në seancën duke vepruar për aktgjykimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*Boshkoski kundër Republikës së Maqedonisë së Veriut*, A.nr.71034/13 të datës 04 qershor 2020, përfundimtare më 04 shtator 2020 dhe *Janevski kundër Republikës së Maqedonisë së Veriut*, A.nr.30259/15 të datës 19 nëntor 2020, përfundimtare më 19 nëntor 2020) dhe në bazë të analizës për zbatimin e denjë të principeve dhe qëndrimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut të shprehura në aktgjykimet e cekura, më 31.01.2022, nxori këto:

K O N K L U Z I O N E

I. Çdoherë kur një dëshmitar i propozuar për tu marrë në pyetje në seancën kryesore në gjykatë, dhe i njëjti nuk mund të sigurohet për shkak të ekzistimit të ndonjëres nga shkaqet e shënuara në nenin 388 paragrafi (5) të LPP, procesverbale për deklarata që janë dhënë para Prokurorit Publik, mund që me vendim të gjykatës të nxirren si provë me lexim ose me reproduktim. Para se të vendoset, nëse do të nxirret si provë e dhënë në hetim, gjykata doemos të shqyrtojë në fillim nëse ekzistojnë shkaqe të arsyetuara për mos prezencën e dëshmitarit në seancën kryesore; nëse deklarata e atij dëshmitari paraqet bazë të vetme ose vendimtare për dënimin e të akuzuarit dhe nëse ekzistojnë faktorë të mjaftueshëm kundërpeshe që të mund të kompensohet pozita e tillë e mbrojtjes si rezultat i pranimit të provës nga një dëshmitar që nuk është marrë në pyetje në seancën kryesore.

Gjyqtarët doemos të kujdesen për drejtësinë në përgjithësi të procedurës penale. Në këtë mënyrë, harmonizimi me kërkesat për gjykim të drejtë, doemos të shqyrtohet për secilin rast në mënyrë të veçantë, duke marrë parasysh zhvillimin e procedurës si tërësi, e jo në bazë të vlerësimit të izoluar në një aspekt të veçantë ose ngjarje.

Principet relevante lidhur me të dhënat ankimore për shkeljen e të drejtave të mbrojtjes për shkak të provave të siguruara nga një dëshmitar që mungon, të prezantuara në rastet *Trampevski*, *Papadakis*, *Boshkoski* dhe *Janeski kundër RMV*, do të zbatohen në të gjitha rastet lidhur me dëshmitarët që mungojnë dhe dëshmitarët me identitet të fshehur (dëshmitarët anonim).

II. Mbajtja e seancave publike gjyqësore (seancë kryesore) paraqet princip themelor për gjykim të drejtë. Me zbatimin transparent të drejtësisë, publiku kontribuon në plotësimin e qëllimit të gjykimit të drejtë, një nga principet themelore të çdo shoqërie demokratike, në kuadër të kuptimit të Konventës dhe ligjeve nacionale. Megjithatë, kërkesa për mbajtjen e seancës kryesore publike nënshtrohet në përjashtime, posaçërisht kur ajo është në interes të moralit, rendit publik ose sigurisë nacionale në një shoqëri demokratike, më tutje atje ku atë e kërkojnë interesat e personave të mitur ose mbrojtja e jetës private të

palëve ose në një masë të nevojshme sipas mendimit të gjykatës në rrethana të veçanta kur publiku do të dëmtonte interesat e drejtësisë. Krahas kësaj, mund të jetë i domosdoshëm që të kufizohet karakteri i hapur dhe publik i procedurave me qëllim, si për shembull, të mbrohet siguria ose privatësia e dëshmitarëve ose të promovohet shkëmbimi i lirshëm i informacioneve dhe mendimeve gjatë zbatimit të drejtësisë.

Në të gjitha rastet, para se të përjashtohet publiku në procedurën penale, gjyqtari duhet konkretisht të konstatojë dhe ti arsyetojë shkaqet për atë se përjashtimi është i domosdoshëm, që të mbrohet interesi publik, ku duhet ta kufizojë sekretin deri në atë masë që është e domosdoshme për rruajtjen e atij interesi. Gjatë konstatimit nëse ai vendim in camera është kompakt me të drejtën e seancës kryesore publike si element përbërës i të drejtës për gjykim të drejtë, me kuptim relevant është ajo që nëse interesi publik është i balancuar me nevojën e hapjes, nëse mbrojtjes i janë prezantuar të gjitha provat dhe nëse procedura si tërësi ka qenë e drejtë.

A r s y e t i m

Spektori i veprave penale të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në seancën e mbajtur më 31.01.2022, diskutoi për analizën e përgatitur të lëndëve në Sektorin e veprave penale nga aspekti i marrjes në pyetje të dëshmitarëve në procedurat penale dhe përjashtimin e publikut dhe u shqyrtuan aktgjykimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*Boshkoski kundër Republikës së Maqedonisë së Veriut*, A.nr. 71034/13 të datës 04 qershor 2020, përfundimtare më 04 qershor 2020 dhe *Janevski kundër Republikës së Maqedonisë së Veriut*, A.nr.39259/15 të datës 19 nëntor 2020, përfundimtare më 19 nëntor 2020) dhe i nxori këto konkluzione:

I. Çdoherë kur një dëshmitar i propozuar për tu marrë në pyetje në seancën kryesore në gjykatë, dhe i njëjti nuk mund të sigurohet për shkak të ekzistimit të ndonjëres nga shkaqet e shënuara në nenin 388 paragrafi (5) të LPP, procesverbale për deklarata që janë dhënë para Prokurorit Publik, mund që me vendim të gjykatës të nxirren si provë me lexim ose me reproduktim. Para se të vendoset, nëse do të nxirret si provë e dhënë në hetim gjykata doemos të shqyrtojë në fillim nëse ekzistojnë shkaqe të arsyetuara për mos prezencën e dëshmitarit në seancën kryesore; nëse deklarata e atij dëshmitari paraqet bazë të vetme ose vendimtare për dënimin e të akuzuarit dhe nëse ekzistojnë faktorë të mjaftueshëm kundërpeshë që të mund të kompensohet pozita e tillë e mbrojtjes si rezultat i pranimit të provës nga një dëshmitar që nuk është marrë në pyetje në seancën kryesore.

Gjyqtarët doemos të kujdesen për drejtësinë në përgjithësi të procedurës penale. Në këtë mënyrë, harmonizimi me kërkesat për gjykim të drejtë, doemos të shqyrtohet për secilin rast në mënyrë të veçantë, duke marrë parasysh zhvillimin e procedurës si tërësi, e jo në bazë të vlerësimit të izoluar në një aspekt të veçantë ose ngjarje.

Principet relevante lidhur me të dhënat ankimore për shkeljen e të drejtave të mbrojtjes, për shkak të provave të siguruara nga një dëshmitar që mungon, të prezantuara në rastet Trampevski, Papadakis, Boshkoski dhe Janeski kundër RMV, do të zbatohen në të gjitha rastet lidhur me dëshmitarët që mungojnë dhe dëshmitarët me identitet të fshehur (dëshmitarët anonim).

II. Mbajtja e seancave publike gjyqësore (seancë kryesore) paraqet princip themelor për gjykim të drejtë. Me zbatimin transparent të drejtësisë, publiku kontribuon në plotësimin e qëllimit të gjyimit të drejtë, një nga principet themelore të çdo shoqërie demokratike, në kuadër të kuptimit të Konventës dhe ligjeve nacionale. Megjithatë, kërkesa për mbajtjen e seancës kryesore publike nënshtrohet në përjashtime, posaçërisht kur ajo është në interes të moralit, rendit publik ose sigurisë nacionale në një shoqëri demokratike, më tutje atje ku atë e kërkojnë interesat e personave të mitur ose mbrojtja e jetës private të palëve ose në një masë të nevojshme sipas mendimit të gjykatës në rrethana të veçanta kur publiku do të dëmtonte interesat e drejtësisë. Krahas kësaj, mund të jetë i domosdoshëm që të kufizohet karakteri i hapur dhe publik i procedurave me qëllim, si për shembull, të mbrohet siguria ose privatësia e dëshmitarëve ose të promovohet shkëmbimi i lirshëm i informacioneve dhe mendimeve gjatë zbatimit të drejtësisë.

Në të gjitha rastet, para se të përjashtohet publiku në procedurën penale, gjyqtari duhet konkretisht të konstatojë dhe ti arsyetojë shkaqet për atë se përjashtimi është i domosdoshëm, që të mbrohet interesi publik, ku duhet ta kufizojë sekretin deri në atë masë që është e domosdoshme për ruajtjen e atij interesi. Gjatë konstatimit nëse ai vendim in camera është kompakt me të drejtën e seancës kryesore publike si element përbërës i të drejtës për gjykim të drejtë, me kuptim relevant është ajo që nëse interesi publik është i balancuar me nevojën e hapjes, nëse mbrojtjes i janë prezantuar të gjitha provat dhe nëse procedura si tërësi ka qenë e drejtë.

Spektori i veprave penale të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, konkluzionet i nxori për tu ndihmuar gjykatave më të ulëta në zbatimin e dispozitave relevante ligjore dhe të praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në mbrojtjen dhe përforcimin e principit të sundimit të së drejtës.

Spektori i veprave penale